



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2019

**LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.**

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga "Qemal Stafa", Elbasan.

Për "**Shpresa - AL**" sh.p.k me adresë: rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center, Pall.11, kati 2, N.J.B. nr.9, Tiranë.

Procedura e prokurimit: "**Kërkesë për propozim**".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 40863-10-24-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Rivitalizim i lulishtes "Kozma Naska", lagjja "Kongresi Elbasanit"**", me fond limit: **7,583,198** (shtatëmilion e pesëqind e tetëdhjetë e tremijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë për vitin 2019, dhe me afat për kryerjen e punimeve **1 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. "Shpresa - AL" sh.p.k me Nipt: K 31321021 N**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **5,670,528** (pesëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **6,804,634** (gjashtëmilion e tetëqind e katërmijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) **lekë** (me tvsh).

**2. "Zdravo" sh.p.k me Nipt: J 84003411 K**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6.738.440,9** (gjashtëmilion e shtatëqind e tridhjetë e tetëmijë e katërqind e dyzet presje e nëntë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **8,086,129** (tetëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e njëzet e nëntë) **lekë** (me tvsh).

### **3. “B-93” sh.p.k me Nipt: J 62903508 R**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **5,133,088** (pesëmilion e njëqind e tridhjetë e tremijë e tetëdhjetë e tetë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **6,159,705** (gjashtëmilion e njëqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e pesë) **lekë** (me tvsh).

### **4. “Avduli” sh.p.k me Nipt: J 66703306 O**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6,965,153** (gjashtëmilion e nëntëqind e gjashëdhjetë e pesëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **8,358,183** (tetëmilion e treqind e pesëdhjetë e tetëmijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë** (me tvsh).

### **5. “Sark” sh.p.k. me Nipt: K 52531415 H**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6.445.849,43** (gjashtëmilion e katërqind e dyzet e pesëmijë e tetëqind e dyzet e nëntë presje dyzet e tre) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **7.735.019,31** (shtatëmilion e shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë e nëntëmbëdhjetë presje tridhjetë e një) **lekë** (me tvsh).

### **6. “Meteo” sh.p.k me Nipt: L 26310801 C**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **7,204,211** (shtatëmilion e dyqind e katërmijë e dyqind e njëmbëdhjetë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **8,645,053** (tetëmilion e gjashtëqind e dyzet e pesëmijë e pesëdhjetë e tre) **lekë** (me tvsh).

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

#### **1. Operatori ekonomik “B 93” sh.p.k. me Nipt: J 62903508 R**

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Operatori Ekonomik në përmbushje të pikës 2.3.5 të Kapacitetit teknik: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier hidroteknik

- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (një) inxhinier mjedisi
- 1 (një) inxhinier gjeolog

Referuar listepagesave te shoqerise “B-93” te paraqitura ne SPE per muajin e fundit rezulton se:

Apostol Mici i deklaruar nga Operatori Ekonomik si inxhinier elektrik , nuk figuron fare në listëpagesat e shoqerisë për periudhen Korrik - Shtator 2019. Gjithashtu, ky inxhinier per muajt Prill dhe Maj 2019, eshte i deklaruar ne listepagese vetem per 1(nje) dite pune me kod 9622.01. Bazuar ne VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR" rezulton se ky kod perkon me profesionin punetor krahu dhe jo inxhinier elektrik.

Keto fakte nuk i sigurojne Autoritetit Kontraktor qe ky OE e disponon ne stafin e tij teknik nje inxhinier elektrik , ne permbushje te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa më sipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: “**Shpresa - AL**” sh.p.k me adresë: rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center, Pall.11, kati 2, NJ.B. nr.9, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **5,670,528** (pesëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anullovë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 14.11.2019**

**Ankesa ka patur.**

Ka patur ankesë nga operatori ekonomik "B 93" sh.p.k. Autoriteti kontraktor pas shqyrtimit të ankesës, me vendimin nr. 10213/5 prot. datë 25.11.2019 vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "B 93" sh.p.k. Ky vendim ju komunikua operatorit ekonomik "B 93" sh.p.k më datë 30.11.2019. Operatori ekonomik "B 93" sh.p.k nuk e dërgoi ankesën për shqyrtim në Komisionin e Prokurimit Publik.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari**

**Irland Sina**